



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:071735

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05513690

C.nr.481/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.Z nga komuna Vushtrri të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.K.B-P nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, lidhur me kompensim të shpenzimeve të udhëtimit për ditët e pranisë në punë, jashtë seance, me datën 27.03.2024, e mori këtë:

A K T G J Y K I M
(pa shqyrtim gjyqësor)

I.APROVOHET pjesërisht padia dhe kërkesëpadia e paditësi R.Z nga komuna Vushtrri, ashtu qe DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditësit R.Z nga komuna Vushtrri në emër kompensimit të shpenzimeve për udhëtim për në punë (në shkallë prej 70% të lartësisë së biletës së udhëtimit) për periudhën kohore prej datës 16.04.2018 e gjerë me datën 16.10.2021, (pra për 639 ditë udhëtimi për në punë) shumën prej 447,30 euro me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë me datën 16.04.2021 e gjerë në në pagesën definitive të detyrimeve si dhe shpenzimet e procedure kontestimore në shumë të përgjithshme prej 104 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

II.Lidhur me shpenzimet e procedures kontestimore dhe atë për përpilim padie dhe taksë gjyqësore, është vendosur sipas aneksmarrëveshjes së arritur pranë ndërmjetësimi në këtë këtë gjykatë brenda kësaj çështjeje kontestimore lidhur me kualifikim/licencim nr. ND.nr.1219/23 datë 21.11.2023.

III. REFUZOHET pjesërisht e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve për udhëtim për në punë (në shkallë prej 70% të lartësisë së biletës së udhëtimit) për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e gjerë me datën 16.04.2018, (pra për 253 ditë udhëtimi për në punë) shumën prej 177,10 euro, për shkak të parashkrimit të kërkesës së paditësit.

A r s y e t i m

Paditësi R.Z nga komuna Vushtrri, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi me datë 16.04.2021, me të cilën pas precizimit – zgjerimti të saj, ka kërkuar që të obligohet e paditura që t’ia kompensoj shpenzimet të udhëtimit për periudhën kohore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes se padisë e gjerë ne pagesën definitive si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilim të precizimit – zgjerimit të kërkesëpadiisë shumen prej 104 euro.

Gjykata me aktvendimin C.nr.481/21 të datës 13.10.2023, ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në padi, ndërsa përgjigjen në padi e ka paraqitur me datë 31.11.2023.

Në përgjigjen në padi e paditura ndër të tjera ka deklaruar se padia dhe kërkesëpadija e paditëseve është parashkruar pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar më 18.04.2017 ndërsa paditësit e ka paraqitur padinë në gjykatë me datë 16.04.2021, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit është me efekt veprimi deri më 18.04.2020 dhe se e njëjta nuk ka efekt për asnjë kërkesë e cila lind pas kësaj date. Ka theksuar ndër të tjera se kërkesa e paditësit është e parashkruar. I ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëseve ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palës nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqës të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësit ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe nga vërtetimi i lëshuara nga Sh.MU-1 Vushtri, e datës 25.03.2024 për R.Z kontestuese nuk ishte prania e paditësit në punë si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë nuk ia ka kompensuar shpenzimet për udhëtim. Kontestuese ishte parashkrimi i kërkesës së paditëses.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se *“kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitorit ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, e lidhur me nenin 35 paragrafi 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 si dhe asaj të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Punëtorëve arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunes përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70 % të biletave të trafikut urban”*, si dhe vërtetimeve të lëshuara për paditësin, gjeti se paditësi R.Z, gjatë periudhës 16.04.2018 e deri më 16.10.2021, ka vijuar punën për 639 ditë me radhë në SH... në Vushtri dhe për të vijuar punën ka udhëtuar në relacionin fshati P... - Vushtri dhe anasjelltas duke paguar çmimin e biletës në një drejtim 0.50 euro, që dmth në ditë ka paguar 1.00 euro, fakte këto të vërtetuara nëpërmjet vërtetimit të datës 25.03.2024, i lëshuar nga SH... Vushtri, përkatësisht vërtetimi i kompanisë së udhëtimeve N.T.Sh.“B...”, pra paditësi për 639 ditë të udhëtimit për në punë ka shpenzuar 639 euro dhe 70 % i kësaj shume, me një kalkulim të thjeshtë, rezulton të jetë në lartësi prej 447,30 euro.

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, gjykata e vlerësoj pjesërisht të bazuar dhe atë për periudhën kohore nga data 18.04.2017-16.04.2018, në pajtim me nenin 87 të Ligjit të Punës, ku është përcaktuar se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Duke pas parasysh se paditësi kërkesën e tij e ka parashtruar për periudhën nga data 18.04.2017-16.10.2021, gjykata gjeti se kërkesëpadija e paditësit me të cilën ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve për udhëtim për në punë (në shkallë prej 70% të lartësisë së biletës së udhëtimit) për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e gjerë me datën 16.04.2018, (pra për 253 ditë

udhëtimi për në punë) në shumë prej 177,10 euro, është e parashkruar pra kërkesë e paraqitur jashtë afatit tre vjeçar, në pajtim me nenin 87 të Ligjit të Punës, andaj edhe vendosi si në pikën III të këtij aktgjykimi.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, paditësit ia njohu edhe të drejtën në kamatë në lartës prej 8%, duke llogaritur nga data 16.04.2021, dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, paditësit ia njohu edhe të drejtën në kamatë në lartës prej 8%, Gjykata përveç kërkesës kryesore, paditëses ia njohu edhe të drejtën në kamatë në lartësi prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive në pajtim me nenin 378 të LPK-së e në pajtim me mendimin juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 01.12.2020.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës vendosi në bazë të nenit 452 të LPK-së ashtu që paditësit ia njohu vetëm shpenzimet për zgjerim padie në shumë prej 104 euro, pasi që lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për përpilim padie dhe taksë gjyqësore, është vendosur sipas aneksmarrëveshjes së arritur pranë ndërmjetësimit në këtë këtë gjykatë brenda kësaj çështjeje kontestimore lidhur me kualifikim/licencim nr. ND.nr.1219/23 datë 21.11.2023.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil

C.nr.481/21, datë: 27.03.2024

Gj y q t a r i
Izet Gërguri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit ne Prishtine.